



НУЦК „ИЉО АНТЕСКИ-СМОК“ - ТЕТОВО
INQK "ILO ANTESKI-SMOK" - TETOVË
NICC "ILO ANTESKI-SMOK" - TETOVO

RAPORTI VJETOR

PËR PUNË DHE PUNËN
FINANCIARE

2021

TETOVË, 2022

Në bazë të nenit 31-b, paragrafi (1) i Ligjit për Kulturë (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 44/2014) dhe nenit 12, pika 10 e Statutit të INQK “Ilo Anteski Smok”-Tetovë, nr. 0101-18/6 miratuar më datë 16.04.2015, Drejtori i Institucionit Nacional Qendra për kulturë “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, paraqet:

**RAPORT VJETOR PËR PUNË DHE PUNËN FINANCIARE TË
INSTITUCIONIT NACIONAL QENDRA PËR KULTURË
”ILO ANTESKI-SMOK”-TETOVË
PËR PERIUDHËN 01.01.2021-31.12.2021**

**TETOVË
2022**

Përmbajtja:

Hyrje.....	4
I. Organet udhëheqëse dhe drejtuese.....	5
I.1. Organ udhëheqës	5
I.2. Organ drejtues.....	5
II. Pagesa të realizuara dhe boxhe të shlyera.....	6
III. Pjesa programore.....	7
III.1. Aktivitetet.....	7
III.2. Raport narativ.....	9
IV. Raporti financiar	16
Përfundimi	21

HYRJE

Qendra për Kulturë „Ilo Anteski-Smok”-Tetovë është ndërtuar në vitin 1973, ndërsa administrata zyrtarisht me punë filloi në vitin 1975. Objekti ka sipërfaqe prej 6500 m², nga e cila 780 m² janë pjesë e skenës.

Për organizim të aktiviteteve skenike, Qendra për kulturë posedon sallë të madhe me 661 ulëse, si dhe sallë të vogël me 50 ulëse për promovime të ndryshme.

Qendra për kulturë është institucion i rëndësishëm për kulturën, aktivitetet kulturore dhe skenike, të cilat realizohen në qytetin e Tetovës dhe rrethinën në përgjithësi. E gatshme për organizim të koncerteve, aktiviteteve të ndryshme muzikore dhe skenike, shfaqje, promovime, ekspozita, koncerte të ansambleve, mbajtje të aktiviteteve politike dhe njëkohësisht me veprimet e veta në mënyrë aktive vepron në promovimin dhe realizimin e vlerave kulturore.

Për çdo vit në këtë objekt aktivitetet e tyre i zhvillojnë qindra aktorë të profileve të ndryshme nga të gjitha nacionalitetet dhe gjuhë të ndryshme, aktorë, muzikantë, këngëtarë, kore, fotograf. Në qendrën për kulturë në vit organizohen mbi 100 aktivitete me mbi 50.000 vizitorë.

I.ORGANET UDHËHEQËSE DHE DREJTUESE

I.1. ORGAN UDHËHEQËS DREJTORI

Institucioni Nacional qendra për kulturë “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, udhëhiqet nga drejtori. Drejtorin e zgjedh ministri i kulturës me konkurs publik të shpallur nga Ministria e Kulturës dhe me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Drejtori i institucionit për periudhën nga 01.01.2021-31.12.2021 vit, ka udhëhequr, koordinuar dhe ka eliminuar të gjitha pengesat e mundshme, për realizim efikas të aktiviteteve amë, aktiviteteve që organizohen nga shoqata si dhe institucione të ndryshme.

I.2. ORGAN DREJTUES KËSHILLI DREJTUES

Këshillin drejtues të Qendrës për kulturë e përbëjnë 5 (pesë) anëtarë të cilët i emëron dhe shkarkon ministri i kulturës, nga të cilët dy janë nga radha e përfaqësuesve nga sfera e kulturës, një është nga pushteti vetë administrimit lokal dhe dy përfaqësues nga të punësuarit në Qendrën për kulturë. Këshilli Drejtues në periudhën nga 01.01.2021-31.12.2021 vit, ka realizuar gjithsej 4 (katër) seanca, të dhëna në mënyrë tabelore.

Data e seancave	Vendime	Pëlqime	Miratime
22.02.2021	3	/	/
16.03.2021	2	/	/
04.05.2021	1	1	1
16.06.2021	1	1	/
06.08.2021	/	/	/
25.12.2021	/	/	1
Gjithsej: 6	7	2	2

II. PAGESA TË REALIZUARA DHE BORXHE TË SHLYERA

INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, në lidhje me procedurat përmbaruese më datë 30.06.2017, përmes zyrës së avokaturës të Avokat Jetmir Bexheti rr. “Ilindenska” nr. 64-Tetovë, deri te Noter Nita Xhaferi rr. “Dervish Cara” nr. 28 Tetovë, në bazë të kontratës nr.03-132/2 më 29.12.2016, ka dorëzuar propozim për sjellje të Aktvendimit në bazë të dokumentit të besueshëm ndaj Komunës së Tetovës (debitor), për realizim të borxhit në vlerë prej 942.400,00 denarë, borxh i mbetur nga faturat e papaguara, për shërbimin shfrytëzim të sallës së madhe për aktivitetet e ndryshme kulturore të organizuara nga ana e Komunës së Tetovës. Për këtë lëndë INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë ka pranuar Aktvendim të plotfuqishëm nga Gjykata e Apeli Gostivar nr. TSZH nr. 286/17, me të cilin Aktvendim, Aktvendimi i Gjykatës Themelore Tetovë TC1 nr.31/17 i datës 01.11.2017 **VËRTETOHET**. Pas aktvendimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit Gostivar nr. TSZH nr. 286/17, nga avokati i autorizuar Jetmir Bexheti më datë 24.04.2018, deri tek përmbaruesi Cvetanka Trenevaska-Tetovë, rr. “JNA” nr.28/1-3, Tetovë, kompetente për njësinë rajonale të Gjykatës Themelore Tetovë, është dorëzuar **kërkesë për përmbarim**.

Në bazë të dokumenteve të besueshme, përmbaruesi Cvetanka Trenevaska ka sjellë urdhëresë për përmbarim nr. 639/18 më datë 24.04.2018, sipas së cilës urdhëresë më datë 17.12.2021 në xhirollogarinë e Qendrës për kulturë Tetovë, nga Komunës e Tetovës janë paguar 1,328,762.00 denarë për borxhin kryesorë në vlerë prej 942,400.00 denarë.

III. PJESA PROGRAMORE

III.1. AKTIVITETET

INQK “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, në objektin e vet për paraqitje të aktiviteteve të ndryshme ka sallën e madhe me kapacitet prej 661 ulësesh dhe sallën e vogël të përshtatshme për promovime të ndryshme me 50 ulëse.

Në periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021, në Qendrën për kulturë, gjithsej janë realizuar 39 aktivitete të ndryshme, nga të cilat shumica janë të veprimtarisë së dramës dhe muzikës. Në këto aktivitete, në Qendrën për Kulturë kanë frekuentuar 8.960 dashamirë të artit të të gjitha kombësive dhe religjioneve në vend.

Në krahasim me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë, për shkak të pandemisë nuk mund të bëjmë ndonjë krahasim, për shkak se në periudha të ndryshme nuk ka pasur protokoll për punë. Aktivitetet vetanake, Qendra për Kulturë i ka realizuar në kuartalin e fundit të vitit 2021, më saktësisht në muajin dhjetor. Projektet që nuk u realizuan, ishin për shkaqe kryesisht të pandemisë, si dhe duhet të theksohet se nga muajo gusht e deri në fillim të muajit dhjetor, foajeja ishte e destinuar si punkt vaksinimi kundër KOVID-19, që edhe e vështirësoi funksionimin normal të institucionit.

Sallën e madhe të Qendrës për Kulturë proporcionalisht e shfrytëzon edhe Teatri i Tetovës, edhe atë çdo të enjte dhe të premte gjatë vitit, si dhe termine të tjera para realizimit të premierave.

Nëse merret parasysh se protokollet nuk lejojnë numër të madh të vizitorëve, mund të thuhet se pothuajse në të gjitha aktivitete ka pas numër maksimal të lejuar, ndërsa një pjesë të aktiviteteve organizatorët ishin të detyruar t'i realizojnë si aktivitete kamertale për shkak të numrave të shtuar të të sëmureve në kohë të ndryshme gjatë vitit dhe t'i iket numrit të madh të vizitorëve.

Aktivitetet të ndara sipas llojit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 në mënyrë tabelare duket kështu:

NR.	LLOJI I AKTIVITETIT	NUMRI I AKTIVITETEVE
1.	Shfaqje	9
2.	Muzikë klasike dhe balet	8
3.	Folklor	3
4.	Ekspozita	5
5.	Panaire	1
6.	Tribuna	4

7.	Takime politike	1
8.	Muzikë argëtuese	3
9.	Aktivitete për fëmijë	1
10.	Aktivitete humanitare	0
11.	Film	1
12.	Veprimtari letrare	3
Gjithsej		39

Sipas kategorisë së moshës:

Nr.	Kategoria e moshës	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	deri 12	3	410
2.	+12	12	2,260
3.	+18	24	6,290
Gjithsej		39	8,960

Aktivitete sipas bazës nacionale:

Nr.	Aktivitet sipas përkatësisë nacionale	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	E përzier	10	3,300
2.	Shqiptare	18	3,210
3.	Maqedonase	10	2,300
4.	Serbe	1	150
5.	Turke	0	0
6.	Rome	0	0
Gjithsej		39	8,960

Qendra për Kulturë ka të lidhur kontrata me të gjithë organizatorët, përveç Teatrit të Tetovës, me të cilët jemi nën një kulm. Gjithashtu, duhet të theksojmë se Qendra e Kulturës ka të lidhura kontratë pa pagesë për sallën e madhe dhe foajenë, sipas pëlqimit të marrë nga Qeveria e R. të Maqedonisë dhe Ministrisë së Kulturës për lirim nga pagesa

Nr.	Kontrata të lidhura	Lirim nga pagesa	Vlera
1.	Me leje nga Ministria e Kulturës dhe Qeveria	1	14.160
2.	Teatri i Tetovës	(68 ditë)	/
Gjithsej			14.160

III.2. RAPORT NARATIV

Shkurt 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
shfaqje	Tetri i Tetovës	12.02.2021	/

01) 12.02.2021 (E premte) – Teatri i Tetovës e realizoj reprizën e shfaqjes “Epshe dhe lakmi”, në regji të Fitim Selimit. Shfaqja u realizua si përgatitje për pjesëmarrje në festival. Nuk kishte të pranishëm.

Maj 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
takim politik	LSDM	09.05.2021	/
tribunë	Biblioteka “Koço Racin”-Tetovë	28.05.2021	60

01) 09.05.2021 (E Diell) – Në hollin e Qendrës për Kulturë u mbajt Kongresi i LSDM-së, dega Tetovë.

02) 28.05.2021 (E premte) – Në hollin e Qendrës për Kulturë, në organizim të IN Biblioteka “Koço Racin” – Tetovë, u bë ndarja e çmimeve për fituesit e konkursit letrar për poezi dhe prozë më të mirë. Në aktivitet morën pjesë 60 pjesëmarrës.

Qershor 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
muzikë klasike dhe balet	Dance Fest	06.06.2021	30
ekspozitë	Komuna e Tetovës	08.06.2021	30
ekspozitë	Komuna e Tetovës	09.06.2021	30
veprimtari letrare	Shoqata “Tradita”	10.06.2021	30
muzikë klasike dhe balet	Komuna e Tetovës	12.06.2021	100

muzikë klasike dhe balet	Komuna e Tetovës	14.06.2021	150
shfaqje	Komuna e Tetovës	15-17.06.2021	450
ekspozitë	Komuna e Tetovës	15.06.2021	30
muzikë klasike dhe balet	Komuna e Tetovës	21.06.2021	150
shfaqje	Teatri i Tetovës	22.06.2021	50
ekspozitë	Komuna e Tetovës	24.06.2021	50
muzikë argëtuese	Komuna e Tetovës	25.06.2021	150
tribunë	Shoqata "Digi School"	26.06.2021	150
veprimtari letrare	Komuna e Tetovës	26.06.2021	50
muzikë klasike dhe balet	Komuna e Tetovës	28.06.2021	150
muzikë argëtuese	Komuna e Tetovës	30.06.2021	150

- 01) 06.06.2021 (E diel) - Në kuadër të festivalit për vallëzim bashkëkohor Dance fest, u realizua solo vallëzimi i artistit frëngo-senegalez, Amala Dianorit. Në aktivitet pati 30 vizitorë.
- 02) 08.06.2021 (E martë) - Në kuadër të edicionit të 8-të të manifestimit kulturor "Vera e Kulturës Tetovare", në foaje të Qendrës për Kulturë u mbajt ekspozita "E bukura dhe libri", e organizuar nga artistët e rinj, nxënës të vitit të tretë të drejtimit artistik të Gjimnazit "7 Marsi", nën udhëheqjen e profesoreshës Nebie Berisha Alimi. Në aktivitet pati 30 vizitorë.
- 03) 09.06.2021 (E mërkurë) - Në foaje të Qendrës për kulturë në organizim të Shoqatës maqedonase-kroate nga Tetova, do të realizohet ekspozita "Kroacia nëpër kohë". Në aktivitet pati 30 vizitorë.
- 04) 10.06.2021 (E enjte) - U realizua edicioni i VIII i manifestimit kulturor "Lidhja na bashkon" të organizuar nga shoqata për kulturë dhe art "Tradita". Në aktivitet pati 30 vizitorë.
- 05) 12.06.2021 (E shtunë) - Në kuadër të Verës Kulturore, në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë mori pjesë Universiteti i Prishtinës me koncert orkestral. Në aktivitet ishin të pranishëm 100 artdashës.

-
- 06) 14.06.2021 (E hënë) - Në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë në Tetovë u mbajt koncerti recital i violinistes Hana Abdullahi. Në aktivitet ishin të pranishëm 150 artdashës.
- 07) 15-17.06.2021 (E martë- e enjte) - Studioja e dramës "Trupi teatral fluturues" shfaq komedinë "FAMILJA E PIKËLLUAR" nga Branislav Nushiq. Në tre paraqitjet pati 450 të pranishëm.
- 08) 15.06.2021 (E martë) - Me një ekspozitë arti nga njëzet vepra, të organizuar në Qendrën për kulturë u finalizua projekti parandalues-edukativ "Ndaloni gjuhën e urrejtjes", i cili realizohet për të tretin vit radhazi nga Departamenti për parandalim, Sektori i punëve të brendshme Tetovë, në bashkëpunim me OSBE-në dhe vetëqeverisjen lokale të Tetovës dhe Gostivarit. Në aktivitet pati 30 të pranishëm.
- 09) 21.06.2021 (E hënë) - Në Qendrën për Kulturë Tetovë u shfaq shfaqja e baletit "Vallëzimi i luleve" e organizuar nga studioja e baletit "Menada" në koreografi të Jelena Mirçevska dhe Natasha Oklevska Momirovska. Në aktivitet pati 150 të pranishëm.
- 10) 22.06.2021 (E martë) - Në sallën e madhe të Qendrës për kulturë keni mundësinë të ndiqni rishfaqjen "Epsh dhe lakmi", të organizuar nga Teatri i Tetovës, autor: EUGENE O'NEILL Regjia: FITIM SELIMI. Me këtë shfaqje Teatri i Tetovës do të marrë pjesë në edicionin e 8-të të festivalit ndërkombëtar Ballkanik të teatrove në Bursa të Turqisë. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.
- 11) 24.06.2021 (E enjte) - Në hollin e Qendrës për kulturë të Tetovës, u realizua ekspozita personale me punime digjitale të titulluar "Dridhjet shpirtërore të digjitalizuara" të artistit dhe Sekretarit shtetëror në Ministrinë e Kulturës, Valmir Aziri. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.
- 12) 25.06.2021 (E premte) – Në organizim të Komunës së Tetovës, në kuadër të "Verës kulturore", në Qendrën për kulturë u mbajt koncerti i solistes Elita Ziberi. Në aktivitet pati 150 të pranishëm.
- 13) 26.06.2021 (E shtunë) – Në organizim të Shoqatës "Digi-school", në Qendrën për kulturë u ndanë diploma për nxënësit e suksesshëm të kësaj shoqate. Në aktivitet morën pjesë 150 vizitorë.
- 14) 26.06.2021 (E shtunë) – Në kuadër të manifestimit "Vera kulturore", shoqata "Oeneum" mbajti mbrëmje letrare. Në aktivitet pati 150 të pranishëm.
- 15) 28.06.2021 (E hënë) - Në Qendrën e kulturës u realizua vallëzimi modern i studios së baletit Menada i titulluar "The unreality of time". Në aktivitet pati 150 të pranishëm.
- 16) 30.06.2021 (E mërkurë) - Në organizim të Komunës së Tetovës, në kuadër të "Verës kulturore", në Qendrën për kulturë u mbajt koncerti i solistit Selami Kolonja. Në aktivitet pati 150 të pranishëm.

Korrik 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
muzikë klasike dhe balet	Komuna e Tetovës	05.07.2021	150
Folklor	Komuna e Tetovës	10.07.2021	150
Shfaqje	Teatri i Tetovës	15-16.07.2021	300
muzikë klasike dhe balet	Komuna e Tetovës	17.07.2021	50

- 01) 05.07.2021 (e hënë) - Në Qendrën e kulturës u realizua festivali për fëmijë "Jabollçinja", si dhe promovimi i albumit "T'mnica" të Nikolla Dimovskit në 40 vjetorin e karrierës së tij. Në aktivitet pati 150 të pranishëm.
- 02) 10.07.2021 (e shtunë) - Shoqata e Serbëve dhe Maqedonasve SHKA "Branko Çajka" nga Tetova, në sallën e madhe të Qendrës për kulturë "Ilo Anteski-Smok" -Tetovë realizoi edicionin e tretë të manifestimit "Lojëra folklorike nën Sharr". Në aktivitet pati 150 të pranishëm.
- 03) 15-16.07.2021 (e enjte- e premte) - Në sallën e madhe të Qendrës për kulturë Teatri i Tetovës realizoi premierën e dramës "Të mallkuarit" nga autorja OLSA POSHKA dhe në regji të GENT M.ÇAJANI. Në aktivitet pati gjithsej 300 të pranishëm.
- 04) 17.07.2021 (e shtunë) – Në organizim të Komunës së Tetovës, në sallën e madhe u mbajt koncert solistik i Jozef Mengës me piano. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.

Gusht 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Film	Komuna e Tetovës	28.08-3.09.2021	1.750

- 01) 28.08-3.09.2021 – TIFF Oda organizoi festivalin e filmit. Gjatë gjithë festivalit u shfaqën 13 filma të metrazhit të gjatë dhe 40 filma të metrazhit të shkurtër. Në aktivitet pati gjithsej 1.750 dashamirë të filmit.

Shtator 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
muzikë klasike dhe balet	Artal	08.09-29.09.2021	750
Tribunë	Ministria e Kulturës	23.09.2021	50

- 01) 08-29.09.2021 – Shoqata Artal – Tetovë, e realizoi Festivalin Ndërkombëtar “Meridians”. Gjithsej në të u realizuan 6 koncerte. Në këtë manifestim pati 750 vizitorë.
- 02) 23.09.2021 (e enjte) U mbajt një prezentim për mënyrën e aplikimit online për projektet me interes nacional në kulturë për vitin 2022. Trajnimin e realizuan përfaqësues të Ministrisë së Kulturës të RMV.

Tetor 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Letečka teatarska trupa	12,28.10.2021	500
Shfaqje	Letečka teatarska trupa	19-20.10.2021	500
Letërsi	Ditët e Naimit	21-23.10.2021	150
Shfaqje	Shoqata Purpura	25.10.2021	50

- 01) 12, 28.10.2021 (e martë) – Në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë u realizua premiera dhe repriza e shfaqjes teatrale për fëmijë “Borëbardhe dhe shtatë xhuxhat” nga Letečka Teatarska Trupa. Në të dy ngjarjet pati gjithsej 500 të pranishëm.
- 02) 19-20.10.2021 (e martë – e mërkurë) - Në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë u realizua premiera dhe repriza e shfaqjes teatrale për fëmijë “E bukura dhe bisha” nga Letečka Teatarska Trupa. Në të dy ngjarjet pati gjithsej 500 të pranishëm.
- 03) 21,23.10.2021 (e enjte, e shtunë) – Në organizim të MLN “Ditët e Naimit” u mbajt edicioni i 25-të të Festivalit ndërkombëtar të poezisë “Ditët e Naimit”, si dhe promovimi i librave. Në ngjarje morën pjesë 200 të pranishëm.
- 04) 25.10.2021 (E hënë) – Në Qendrën për kulturë në Tetovë u shfaq shfaqja “Tom, Xeri dhe Beni”, e organizuar nga Shoqata “Purpura” dhe Qendra për autizëm “Fluturo për jetën”. Në aktivitet morën pjesë 50 artdashës.

Nëntor 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Tribunë	Aleanca e luftëtarëve	18.11.2021	200
Folklor	Shoqata e pedagogëve shqiptarë	22.11.2021	300
Shfaqje	QK "I.A.-Smok"	30.11.2021	50

- 01) 18.11.2021 (e enjte) – Aleanca e luftëtarëve të Tetovës, mbajtën takim vjetor me rastin e çlirimit të Tetovës/ Në aktivitet pati 200 të pranishëm.
- 02) 22.11.2021 (e hënë) – Me rastin e ditës së Alfabetit shqip, SHKA Xheladin Zeqiri organizoi një koncert vjetor. Në aktivitet pati 300 të pranishëm.
- 03) 30.11.2021 (e martë) – Në organizim të Qendrës për Kulturë, ndërsa mbështetur nga Ministria e Kulturës u realizua premiera e shfaqjes për fëmijë “Kutia magjike” në regji të Marko Bogdanovskit. Në ngjarje pati 50 të pranishëm.

Dhjetor 2021

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	QK "I.A.-Smok"	30.11.2021	50
Aktivitet për fëmijë	Bletëzat	02.12.2021	300
Folklor	QK "I.A.-Smok"	09.12.2021	300
Ekspozitë	ЦК „И.А.-Смок“	10.12.2021	150
Shfaqje	Teatri i Tetovës	16-17.12.2021	100
Muzikë zbavitëse	Studioja e dramës	25.12.2021	300
Panair	Shoqata e botuesve shqiptarë	27-31.12.2021	1.000

- 01) 01.12.2021 (e mërkurë) - Në organizim të Qendrës për Kulturë, me mbështetje të Ministrisë së Kulturës u realizua repriza e shfaqjes “Kutia magjike”, në regji të Marko Bogdanovskit. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.
- 02) 02.12.2021 (e enjte) – Në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë u realizua festivali për fëmijë “Bletëzat” ku morën pjesë fëmijë nga Tetova dhe rajoni. Në aktivitet kishte 300 të pranishëm.

-
- 03) 09.12.2021 (e enjte) – Në organizim të Qendrës për Kulturë, a mbështetur nga Ministria e Kulturës, u realizua edicioni i 10-të i Festivalit të këngëve qytetare “Teuta”. Gjithsej u paraqitën 5 grupe edhe atë nga Tetova, Gostivari, Kumanova, Presheva dhe Prishtina. Në aktivitet kishte 300 vizitorë.
- 04) 10.12.2021 (e premte) - Në organizim të Qendrës për Kulturë, a mbështetur nga Ministria e Kulturës, u realizua ekspozita kolektive me fotografi e titulluar “Moment”, ku morën pjesë artistë nga rajoni si dhe nga Gjermania dhe Egjipti. Në aktivitet pati 150 vizitor.
- 05) 16-17.12.2021 (e enjte- e premte) – Teatri i Tetovës realizoi premierën dhe reprizën e shfaqje kamertale në gjuhën maqedonase “Dasma provinciale”. Në aktivitet pati 100 të pranishëm.
- 06) 25.12.2021 (e shtunë) – Në sallën e madhe të Qendrës për kulturë u realizua edicioni i shtatë i manifestimit “Edhe aktorët tetovarë këndojnë”, që tradicionalisht mbahet para Vitit të Ri. Në aktivitet pati 300 të pranishëm.
- 07) 27-31.12.2021 (e hënë- e premte) – Në organizim të Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, u realizua panairi i librit. Këtë panair e frekuentuan 1.000 vizitorë.

IV. RAPORTI FINANCIAR

Peruidha prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

TË DALAT, ZËRI 401 - RROGA BAZË

Të punësuarit të cilët me aktivitetin e tyre kontribuojnë për realizimin e programit vjetor të institucionit, vlera për pagat dhe tatimin personal është 8,543,502.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 402 – KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË

Detyrimet të cilat rrjedhin nga pagesa e borxheve kundrejt puntorëve për kontributet janë në vlerën gjithsej 3,322,466.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 421 – SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI

Shpenzimet e Qendrës për Kulturë të energjisë elektrike për 6500 m² të hapsirë shfrytëzuese, dhe atë që e shfrytëzon infrastruktura dhe institucionet e tjera si: Teatri i Tetovës, Këndi Amerikan (American Corner Tetovo) janë në vlerë gjithsej 759,439.00 denarë. Aktivitetet e liruara nga pagesa nga ana e Ministrisë së Kulturës ndikojnë mbi buxhetin e Qendrës për Kulturë, dyfish më shumë sepse zhvillohen gjatë kohës kur kërkesat për aktivitete janë më të mëdha. Shpenzimet për energji elektrike, ujësjellësi dhe kanalizimi, taksa dhe shërbime tjera komunale, materiale tjera për ngrohje, posta, telefon, janë gjithsej në vlerë prej 1,712,347.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 423 – MATERIALET DHE INVENTARI I IMËT

Në kategorinë e shpenzimeve të realizuara për materialet dhe inventarin e imët janë kalkuluar lloje dhe sasi materialesh të cilët janë të domozdoshme për kryerjen e obligimeve dhe detyrave: material zyre, material për AOP, униформа, produkte ushqimore, mjete për mirëmbajtjen e higjienës, inventari i imët, materiale për riparime të ndryshme, materiale tjera. Shpenzimet e këtij zëri janë në vlerë prej 135,782.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 424 – RIPARIME DHE MIRËMBAJTJE AKTUALE

Për projektin “Renovimi i tualeteve në qendrën për kulturë”, janë paguar 249,452.00 denarë. Për riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve softverike dhe mirëmbajtje të hapësirave të gjelbërta shpenzimet kapin vlerën 45,168.00 denarë. Vlera gjithsej e kësaj kategorie të shpenzimeve është 294,620.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 425 – SHËRBIMET KONTRAKTUESE

Vlera gjithsej e këtij zëri për pagesën e shpenzimeve për sigurim të automjeteve, shërbimeve tjera arsimore dhe shërbimeve tjera kontraktuese është 28,199.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 426 – SHPENZIMET TJERA RRJEDHËSE

Në këtë kategori të të dalurave, shpenzimet për shpallje publike janë në vlerë gjithsej 36,312.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 464 – TRANSFERE TË NDRYSHME

Vlera e këtij zëri për qëllime programore dhe shpenzime materiale është gjithsej 1,225,783.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 480 – BLERJA E PAISJEVE DHE MAKINERISË

Shpenzimet për blerjen e pajisjeve të zyrës janë në vlerë gjithsej 12,000.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 482 – OBJEKTE TË TJERA NDËRTIMORE

Në ciklin e investimeve në të cilin përfshihet institucioni jonë si bartës i ndërtimit të objektit të Institucionit Nacional Teatri dhe Biblioteka e Tetovës, sipas Aneks Kontratës nr. 20-2064/1 me date 31.12.2021, “Faza e dytë për ndërtimin e objektit të ri të teatrit dhe bibliotekës në Tetovë”, në bazë të situacionit me avans, ndaj Grupit të ofertuesve me përfaqësues D.G.T.U. “NB-COMPANY” DOO Tetovë është realizuar vlera prej 69,500,000.00 denarë. Mjetet financiare të shpenzuara për **ideen projekt** për projektin “Rikonstruimi i strukturës së kulmit-kupollë” janë në vlerë prej 59,000.00 denarë. Vlera gjithsej e kësaj kategorie të shpenzimeve është 69,559,000.00 denarë.

Bashkangjitje: Paraqitja tabelare e Raportit financiar të INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë.

I. TË HYRAT

ZËRI	PËRSHKRIMI I ZËRIT	VLERA (DENARË) ZËRI 603	VLERA (DENARË) ZËRI 631	VLERA (DENARË) ZËRI 787	VLERA (DENARË) ZËRI 785	GJITHSEJ
723911	Qeraja nga objektet	0.00	781,151.00	1,664,111.00	0.00	2,445,262.00
725941	Të hyrat nga vitet e kaluara	0.00	0.00	0.00	286.00	286.00
741112	Transfere nga buxheti R.M.V.	83,941,689.00	0.00	0.00	0.00	83,941,689.00
	GJITHSEJ TË HYRA	83,941,689.00	781,151.00	1,664,111.00	286.00	86,387,237.00

II. TË DALAT

ZËRI	PËRSHKRIMI I ZËRIT	VLERA (DENARË) ZËRI 603	VLERA (DENARË) ZËRI 631	VLERA (DENARË) ZËRI 787	GJITHSEJ
401	RROGA BAZË	8,543,502.00	0.00	0.00	8,543,502.00
401130	Rroga bazë	7,931,183.00	0.00	0.00	7,931,183.00
401310	Tatimi personal i të ardhurave të rrogës	612,319.00	0.00	0.00	612,319.00
402	KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË	3,322,466.00	0.00	0.00	3,322,466.00
402110	Kontributet bazë të SPI	2,230,817.00	0.00	0.00	2,230,817.00
402210	Kontributet bazë të shëndetësisë	889,955.00	0.00	0.00	889,955.00
402220	Kontributet personale shtesë	59,308.00	0.00	0.00	59,308.00
402310	Kontributet bazë të entit për punësim	142,386.00	0.00	0.00	142,386.00

421	SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI	1,663,210.00	45,342.00	3,795.00	1,712,347.00
421110	Energjia elektrike	759,439.00	0.00	0.00	759,439.00
421120	Ujësjiellësi dhe kanalizimi	66,866.00	0.00	0.00	66,866.00
421190	Taksa dhe shërbime tjera komunale	36,949.00	0.00	0.00	36,949.00
421290	Materiale tjera për nxemje	792,107.00	0.00	0.00	792,107.00
421310	Posta	7,849.00	10,784.00	948.00	19,581.00
421320	Telefon dhe telefaks	0.00	34,558.00	2,847.00	37,405.00
423	MATERIALE DHE INVENTARI I IMËT	0.00	132,302.00	3,480.00	135,782.00
423110	Materiale zyre	0.00	17,950.00	0.00	17,950.00
423210	Materiale për AOP	0.00	10,140.00	500.00	10,640.00
423310	Uniformat	0.00	14,349.00	0.00	14,349.00
423410	Produkte ushqimore	0.00	18,120.00	2,980.00	21,100.00
423710	Produkte për mirëmbajtje të higjienës	0.00	22,825.00	0.00	22,825.00
423720	Materiale për riparime të ndryshme	0.00	26,278.00	0.00	26,278.00
423810	Intentar i imët	0.00	14,580.00	0.00	14,580.00
423990	Materiale tjera	0.00	8,060.00	0.00	8,060.00
424	RIPARIME DHE MIRËMBAJTJE AKTUALE	249,452.00	27,918.00	17,250.00	294,620.00
424210	Mirëmbajtja e ndërtesave	249,452.00	0.00	0.00	249,452.00
424420	Riparime dhe mirëmbajtja e pajisjeve softverike	0.00	27,918.00	0.00	27,918.00
424590	Mirëmbajtja e hapësirave tjera të gjelbërta	0.00	0.00	17,250.00	17,250.00

425	SHËRBIME KONTRAKTUESE	0.00	22,299.00	5,900.00	28,199.00
425260	Sigurimi i automjeteve	0.00	9,259.00	0.00	9,259.00
425790	Shërbime tjera arsimore	0.00	9,500.00	0.00	9,500.00
425990	Shërbime tjera kontraktuese	0.00	3,540.00	5,900.00	9,440.00
426	SHPENZIME TJERA RRJEDHËSE	0.00	36,312.00	0.00	36,312.00
426410	Publikim i thirjes	0.00	36,312.00	0.00	36,312.00
464	TRANSFERE TË NDRYSHME	604,059.00	450,435.00	171,289.00	1,225,783.00
464990	Transfere tjera	604,059.00	450,435.00	171,289.00	1,225,783.00
480	BLERJA E PAJISJEVE DHE MAQINERISË	0.00	12,000.00	0.00	12,000.00
480110	Blerja e pajisjeve të zyrës	0.00	12,000.00	0.00	12,000.00
482	OBJEKTET TJERA NDËRTIMORE	69,559,000.00	0.00	0.00	69,559,000.00
482210	Pregaditja e projekteve	59,000.00	0.00	0.00	59,000.00
482920	Ndërtimi i objekteve tjera	69,500,000.00	0.00	0.00	69,500,000.00
GJITHSEJ TË DALA		83,941,689.00	726,608.00	201,714.00	84,870,011.00

I. GJITHSEJ TË HYRA	86,387,237.00
II. GJITHSEJ TË DALA	84,870,011.00
FITIMI NETO I REALIZUAR MBI TË HYRAT	1,517,226.00

PËRFUNDIMI

Si përmbledhje e gjithçkaje të lartëpërmendur mund të përmend elementet e mëposhtme:

- Periudha prej më 01.01.2021–31.12.2021 Qendra për Kulturë e përfundon me bilans pozitiv të suksesit;
- Planifikimet financiare të shpenzimeve tre mujore te Qendrës për Kulturë nuk janë respektuar plotësisht nga Ministria e Kulturës;
- Të gjendet zgjidhje për menaxhimin reciprok me Teatrin e Tetovës për shpenzimet dhe të hyrat për mirmbajtjen dhe shfrytëzimin e të gjithë infrastrukturës tonë.

Punuar nga:

Artan Arslani, Udhëheqës programor _____

M-r Sheval Sulejmani, Këshilltar për punë të përgjithshme administrative dhe punë juridike _____

Luljeta Shaqiri, Këshilltar për punë materiale financiare _____

Dashnor Agolli, Udhëheqës i Sektorit për punë materiale-financiare dhe kontabilitet _____

INQK “Ilo Anteski-Smok”
Drejtore

M-r Arlind Huseini

